



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3, al. 1, pika “b” të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000 dhe nenit 19, al.1, pika “b” të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 03.06.2004 merr

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E
AUTOPARKUT PARA KOMPLEKSIT TË QKU-së NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e autoparkut, para kompleksit të QKU-së në Prishtinë.

Neni 2

Me këtë Vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e autoparkut para kompleksit të Qendrës Klinike Universitare, në Prishtinë.

Lokacioni, nga alinea 1 e këtij neni, përfshinë pjesën e ngastrës kadastrale nr. 2786/1 e evidencuar në fletën poseduese nr. 4137 komuna kadastrale Prishtinë, në sipërfaqe prej 3.0 ha, pronë e Komunës.

Neni 3

Ndërtimi dhe shfrytëzimi i autoparkut, sipas këtij Vendimi, bëhet sipas programit dhe detyrës projektuese të Komunës, e në bazë të koncesionit me ofertuesin e zgjedhur konform me rregullativën ligjore nga lëmi i prokurimit.

Marrëdhëniet obligative me ofertuesin, nga alinea 1 e këtij neni, do të rregullohen me kontratë të veçantë me Komunën.

Përmbajtja e kontratës, nga alinea 2. e këtij neni, para se të nënshkruhet nga palët kontraktuese, duhet të prezentohet për shqyrtim dhe miratim në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin Komunal të Prishtinës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Drejtoria e Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë, Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi dhe Drejtoria për Shërbime Publike, Transport dhe Mbrojtje të Ambientit, të Komunës së Prishtinës, do të kryejnë veprime nga përgjegjësia e tyre, e caktuar për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. NR. 353-1430 DT. 08.06.2004

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri